



Rreth Këshillit të Evropës

I krijuar që në vitin 1949, Këshilli i Evropës kërkon zhvillimin e parimeve të përbashkëta dhe demokratike, bazuar në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe tekstet e tjera bazë për mbrojtjen e individëve, duke përfshirë dhe fëmijët.

Programi "Të ndërtojmë një Evropë për fëmijët dhe me fëmijët" është krijuar për të siguruar dhe për të nxitur të drejtat e njeriut të fëmijëve dhe për të mbrojtur fëmijët nga të gjitha format e dhunës.

Building a Europe for and with children
Council of Europe
F-67075 Strasbourg Cedex
www.coe.int/children
children@coe.int

© Këshilli i Evropës – Ilustrimet: Lotte Klaver



Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve kundër Shfrytëzimit dhe Abuzimit Seksual

Shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual janë ndërmjet formave më të këqija të dhunës kundër fëmijëve. Sipas Unicef-it, çdo vit përdoren për "industrinë e seksit" afërsisht 2 milionë fëmijë. Ka më shumë se 1 milionë imazhe të 10-20000 fëmijëve seksualisht të abuzuar të botuara në internet. Pjesa më e madhe e këtyre fëmijëve janë anonimë, të braktisur dhe mbase akoma abuzohen.

Nuk ka statistika për shtrirjen e abuzimit seksual në Evropë, por njihet gjerësisht që ka një mospërputhje të madhe ndërmjet numrit të rasteve të raportuara dhe të rasteve aktuale. Të dhënat që kemi dëshmojnë që në Evropë pjesa më e madhe e abuzimeve seksuale kryhet brenda familjes, nga persona pranë fëmijëve, ose nga persona në mjedisin social të tyre. Mbrojtja e fëmijëve nga dhuna, në veçanti nga dhuna seksuale, ka qenë dhe mbetet një përparësi e Këshillit të Evropës.



Cili është qëllimi i Konventës?

Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve kundër Shfrytëzimit dhe Abuzimit Seksual është një hap i rëndësishëm për parandalimin e veprave seksuale kundër fëmijëve, për ndjekjen e autorëve të këtyre veprave dhe mbrojtjen e viktimave fëmijë.

Mbrojtja e fëmijëve është mu në zemër të Konventës. Konventa përqendrohet në të gjithë tekstin e saj në respektimin e të drejtave të fëmijëve, duke siguruar mirëqenien e tyre, duke iu përgjigjur pikëpamjeve, nevojave dhe shqetësimeve të tyre dhe duke vepruar gjatë të gjithë kohës në interesin më të mirë të fëmijëve.



Çfarë u kërkon Konventa shteteve?

Masa parandaluese

- ▶ Përzgjedhjen, rekrutimin dhe trajnimin e personave që punojnë në kontakt me fëmijët;
- ▶ Të sigurojnë që fëmijët të bëhen të ndërgjegjshëm për rreziqet e shfrytëzimit seksual dhe të abuzimit seksual dhe për mënyrën sesi të mbrojnë veten;
- ▶ Të sigurojnë masa, të cilat monitorohen në mënyrë të rregullt, si për autorët e veprave dhe për autorët e mundshëm të veprave, me synimin e parandalimit të veprave kundër fëmijëve.

Masa mbrojtëse

- ▶ Krijimin e programeve për mbrojtjen e viktimave dhe të familjeve të tyre. Krijimin e ndihmës terapeutike dhe të kujdesit psikologjik të urgjencës;
- ▶ Inkurajimin e raportimit të dyshimit për shfrytëzim ose abuzim seksual;
- ▶ Krijimin e linjave telefonike dhe të internetit për ofrimin e këshillimit.

Masa në të drejtën penale

- ▶ Të sigurojnë që lloje të caktuara sjellje përbëjnë vepra penale, të tilla si pjesëmarrja në aktivitete seksuale me një fëmijë nën moshën ligjore për aktivitete të tilla;
- ▶ Kriminalizimin e sjelljes që përdor teknologjitë e reja, në veçanti internetin, për dëmtimin seksual të fëmijëve, për shembull duke i ekspozuar ata (për qëllime seksuale);
- ▶ Krijimin e kriterëve të përbashkëta të qarta për të siguruar një sistem ndëshkues efektiv, përpjesëtimor dhe parandalues.
- ▶ Mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave për autorët e dënuar të veprave seksuale kundër fëmijëve.

Hetim dhe procedura gjyqësore miqësore ndaj fëmijëve

- ▶ Sigurimin e mbrojtjes së mirë të viktimave fëmijë gjatë proceseve gjyqësore dhe sigurimin që trauma e kaluar prej tyre të mos përkeqësohet;
- ▶ Mbrojtjen e privatësisë, identitetit dhe imazhit të viktimave fëmijë;
- ▶ Krijimin e masave të përshtatshme për nevojat e viktimave, duke respektuar të drejtat e fëmijëve dhe të familjeve të tyre;
- ▶ Kufizimin e numrit të intervistave me viktimat fëmijë; sigurimin që intervista të tilla zhvillohen në mjedise të përshtatshme, me profesionistë të trajnuar për këtë qëllim.

Monitorim

- ▶ Krijimin e një mekanizmi specifik monitorimi për të siguruar zbatimin e Konventës. Kjo siguron përputhshmërinë e shteteve me Konventën dhe është garanci e efektivitetit të saj afatgjatë.

Cilat vepra mbulohen?

Konventa e përshkruan sjelljen që përbën shfrytëzim seksual dhe abuzim seksual në nenin 18 – 23.

Kjo është hera e parë që një marrëveshje ndërkombëtare e identifikon dhe e kriminalizon veprën e abuzimit seksual. Kërkimet kanë treguar se abuzimi seksual i fëmijëve nga persona që ata njohin ose me të cilët shoqërohen është një ndër format psikologjike më dëmtuese të dhunës seksuale ndaj fëmijëve, me pasoja afatgjata tek viktimat. Konventa i kriminalizon rastet kur një i rritur kryen marrëdhënie seksuale me një fëmijë, në veçanti kur përdoret forca ose kërcënimet.

Konventa gjithashtu parashikon si vepër penale:

- ▶ Veprat që kanë lidhje me pornografinë e fëmijëve
Kërkesa për prostituim fëmijësh është rritur në mënyrë të ndjeshme dhe lidhet shpesh me krimin e organizuar dhe me trafikimin. Konventa përcakton lidhje ndërmjet kërkesës dhe ofertës për prostituim fëmijësh, duke kërkuar sanksione penale si për "rekrutuesit" dhe për "përdoruesit".
- ▶ Veprat e lidhura me pornografinë e fëmijëve;
Prodhimi, ofrimi, shpërndarja, mbajtja dhe shikimi online i pornografisë së fëmijëve kriminalizohen nga Konventa.
- ▶ Ofrimi i fëmijëve për qëllime seksuale;

Ekspozimi është përfshirë për herë të parë në një marrëveshje ndërkombëtare, duke reflektuar fenomenin shqetësues në rritje të fëmijëve të dëmtuar seksualisht kur takohen me të rritur të takuar më parë në hapësira kompjuterike, në veçanti në sitet e komunikimit në internet ose në faqet e internetit për lojëra. Termi "ekspozim" i referohet përgatitjes së fëmijës për abuzim seksual, e motivuar nga dëshira për të përdorur fëmijën për kënaqësi seksuale.



Kush mund të dënohet?

Çdokush që kryen çdonjërin nga veprat e përcaktuara në Konventë mund të jetë objekt ndjekje. Në lidhje me veprat më të rënda, dhe në rastet kur vepra është kryer në një shtet ku e njëjta sjellje nuk kriminalizohet, autori i veprës mund të ndiqet penalisht kur të kthehet në vendin e tij/saj të lindjes. Kjo parashikohet për të luftuar fenomenin e turizmit për arsye të abuzimit seksual me fëmijët.